



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

RAPORTI - VJETOR

I PUNËS SË

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SHKALLËS PARË SHKODËR

VITI 2017

HYRJE

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, të nenit 50 të ligjit nr. 97/2016, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm me Nr.330, datë 29.12.2016, “Për përmbajtjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë”, paraqes përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm të Republikës së Shqipërisë, raportin vjetor të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprimtarine e punës, për vitin 2017.

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm!

Së pari, shfrytëzoj rastin për t’ju falendëruar për mbështetjen që i keni dhënë punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër nga dita e pare e punës Tuaj, mbështetje e cila na bën më optimist dhe na ka inkurajuar për të përmbushur më me korrektësi detyrimet tona kushtetuese dhe ligjore.

Nepërmjet këtij raporti, do të pasqyrojmë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar treguesit e punës për periudhën njëvjeçare, ku në tërësi vihet re një ngarkesë e cila në disa drejtime është përballuar me sukses nga trupa e prokurorëve të ndihmuar nga oficerët e policisë gjyqësore, në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimit e akuzës në gjykim si dhe kryerjes në tërësi të detyrimeve ligjore.

Sipas strukturës të bashkëngjitur udhërit të Prokurorit të Përgjithshëm, për përgatitjen e raportit vjetor, paraqesim të dhënat si më poshtë:

PËRMBAJTIA

I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2017

- Respektimi i të drejtave të njeriut;
- Të miturit dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktima;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive;
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të KM dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre;
- Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtronjë funksione publike;
- Problematikat e hasura.

II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë për vitin 2017.

- Volumi i punës në hetim;
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë;
- Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë;
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale;
- Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror;
- Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë;
- Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre;
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal.

III. Treguesit statistikorë 1 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal.

- Numri i procedimeve të regjistruara, numri i procedimeve të dërguara për gjykim, numri i të pandehurve nën hetim të regjistruar, numri i të pandehurve të dërguar për gjykim, numri i të pandehurve të dënuar.

IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Shkodër.

- Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve;
- Të dhëna për gjykimet e posaçme;
- Të dhëna mbi llojet dhe masat e denimeve/ kërkesa e prokurorit dhe vendimet e gjykatës;
- Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si gjinia, mosha, arsimi, punësimi, etj;
- Të dhëna për të pandehurit e mitur, numri i procedimeve të regjistruara, numri i procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të mitur të regjistruar, të dërguar për gjykim, të dënuar, numër procedimesh regjistruar, masa sigurimi e denime të zbatuara, denime alternative, etj;
- Të dhëna për pasojat e veprave penale.

V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

- Ekstradime;
- Letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letër porositë për jashtë;
- Njohjet e vendimeve penale, njohjet e vendimeve penale të huaja dhe njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit;
- Transferimet e procedimeve penale;
- Transferimet e personave të dënuar;
- Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.

VI. Të dhënat për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore.

VII. Informacion mbi administrimin e prokurorisë

- Përfshirë zbatimin e buxhetit, marrëdhëniet me mediat dhe publikun, rregullsia e mbajtjes së regjistrave dhe raporteve mbi zbatimin e CAMS, kapacitetet infrastrukturale dhe siguria, respektimi i disiplinës në punë dhe etikës nga punonjësit.

VIII. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin pasardhës dhe rekomandime.

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2017

Për vitin 2017, Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë Shkodër, ka pasur për qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në ushtrimin me efikasitet të ndjekjes penale, rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, rritjen e përfomancës në mbrojtjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim si dhe kryerjen në tërësi të detyrave të ngarkuara me ligj, akte nënligjore, urdhëra dhe udhëzime që normojnë dhe rregullojnë punën në mirë funksionimin e prokurorisë.

Prioritet dhe në fokus të veprimtarisë së prokurorisë, ka qënë ndëshkimi i korrupsionit dhe krimeve të rënda. Po ashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe veprave penale të ndjekura me hetim proaktiv për disa procedime, ku evidentohet se ka mundësi për t'i aplikuar më gjërë dhe më shumë këto metoda në drejtim të veprave të tjera penale.

Gjithashtu një vëmendje e vazhdueshme i është kushtuar veprave penale të krimeve kundër jetës, si dhe veprave penale që lidhen me narkotiket (283, 284 etj), ku në bashkëpunim me strukturat ligjzbatuese në vend, në çdo rast sa herë kemi ardhur në dijeni për aktivitete kriminale në këto fusha, janë regjistruar procedime dhe kryer hetime proaktive, për këto vepra penale, duke arritur edhe rezultate disi të kënaqshme.

Në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, në vijimësi janë kryer trajnime të prokurorëve dhe në veçanti të oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë dhe të Drejtorisë e Komisariateve që përfshin kjo Prokurori, me qëllim hartimin e akteve sipas parashikimeve procedurale penale dhe shmangien e pavlefshmërive apo papërdorshmërive në hetim dhe në gjykim. Në këtë drejtim vlerësojmë se vërehen përmirësime, por gjithshmonë mbetet punë për përmirësime të tjera.

Respektimi i të drejtave të njeriut.

Gjatë ushtrimit të ndjekjes penale konstatohet se është bërë përpjekje për t'i kushtuar rëndësi garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke respektuar garancitë procedurale të personave nën hetim dhe të pandehurve, të lirë ose të arrestuar, garantimin e mbrojtësit në rastet e detyrueshme, në respektimin e garancive të veçanta për të miturit në rolin e personit nën hetim, si të pandehur ose dëshmitar, në krijimin e kushteve dhe klimës së veçantë të trajtimit gjatë pyetjes së tyre, praninë e mbrojtësit ligjor dhe psikologut, njoftimin e akteve në përputhje me garancitë procedurale të personave nën hetim, të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre etj. Gjithashtu, janë bërë përpjekje në respektimin e të drejtave dhe garancive dhe mbrojtjen e viktimave të veprave penale, si detyrim ligjor që rrjedh nga ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale.

Por, konstatoj se ka vend për përmirësim në punën e prokurorëve dhe of.pol.gjyqësore, pasi vihet re në disa raste se mangësitë e respektimit me rigorozitet të këtyre detyrimeve procedurale, kanë sjellë si pasojë procese penale jo efektive, si rezultat i konstatimit të pavlefshmërisë e papërdorshmërisë akteve procedurale gjatë gjykimit të tyre.

Gjithashtu, mendoj se duhet punuar më shumë në drejtim të implementimit më mirë në praktikë të ndryshimeve që Kodi i Procedurës Penale pësoi me ligjin Nr.35, të vitit 2017, në raport me të drejtat e viktimës së veprës penale dhe me ligjin Nr.37, viti 2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Në këtë këndvështrim, kemi planifikuar trajnim me kapacitetet tona të Of.Pol.Gjyqësore si në seksionin pranë Prokurorisë dhe të seksionit pranë Policisë së Shtetit, por çmoj se duhen nxjerrë urdhëra dhe udhëzime më të detajuara dhe duhen kryer trajnime vazhduese edhe për prokurorët pranë “Seksionit për të Miturit”.

Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktimë

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në procesin penal ka qënë dhe mbetet një sfidë për ne. Me futjen në fuqi të ligjit Nr.37, viti 2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, para prokurorëve dhe of.pol.gjyqësore dalin detyra të reja në kuptim të implementimit të plotë të këtij ligji në punën tonë, me këtë kategori subjektësh. Për këtë, kemi krijuar Seksionin e të Miturve pranë Prokurorisë, duke angazhuar 3 (tre) prokuror dhe 3 (tre) of.pol.gjyqësore me përvojë. Gjatë këtij viti, ka pasur vëmendje të shtuar në punën tonë, duke respektuar urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm “*Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur person nën hetimi, i dëmtuar ose dëshmitar*”, duke siguruar pjësmarrjen e psikologut gjatë hetimit si dhe është ruajtur sekreti i informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore dhe provave të mbledhura nga policia gjyqësore, për hetimin në ngarkim të të pandehurve të mitur.

Bashkëpunimi ndërinstitucional.

Në përmbushjen e veprimtarisë së prokurorisë një rol të rëndësishëm ka dhe bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat ligjzbatuese në vend, veprimtaria e të cilave është e lidhur ngushtë me punën e prokurorisë. Në këto marrëdhënie rol kryesor kanë pasur marrëdhëniet me Prokurorinë e Përgjithshme, duke mbajtur një raport bashkëpunimi me secilën nga drejtoritë përkatëse, kryesisht me drejtorinë e marrëdhënjeve juridiksionale me jashtë, drejtori e cila luan një rol të rëndësishëm në krijimin e raporteve të komunikimit dhe koordinimit të marrëdhënjeve juridiksionale me jashtë. Këtu dua të ndalem në faktin se, kemi zvarritje të hetimeve në pritje të ekzekutimit të letërporosive të dërguara nga ana jonë

Autoriteteve Gjyqësore të Huaja, për procedime penale të caktuara dhe mendoj se drejtorinë e marrëdhënjeve juridiksionale me jashtë, duhet të bëj më shumë sesa thjeshtë përcjelljen e akteve Ministrisë së Drejtësisë për t'i dhënë rrugë, por dhe të komunikoje me autoritetet homologe që të shpejtohet si proces.

Një raport i mirë bashkëpunimi është mbajtur dhe me Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, ku në raste të ankimeve ndaj vendimeve për çështje me dinamikë është diskutuar në vazhdimësi për çështje konkrete.

Po ashtu, raporte të mira bashkëpunimi kemi pasur dhe me Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore me të cilat kemi kaluar apo pranuar procedime penale për shkak të kompetencës lëndore apo tokësore, kryesisht lidhur me procedimet penale me të mitur.

Raportet me Gjykatën e Shkallës Parë Shkodër, pa dashur të anashkaloj vlerësimin pozitiv për bashkëpunimin që kemi pasur gjatë këtij viti, si me drejtuesin e saj, gjyqtarët dhe administratën, ka vend sipas mendimit tonë, për përmirësim të vazhdueshëm të punës në administrimin, trajtimin dhe ruajtjen e sekretit mbi kërkesat tona, kryesisht rreth atyre me objekt “autorizimin apo vlerësimin e përgjimeve telefonike apo ambientale”, caktimin e masave të sigurimit në mungesë, si dhe marrjen në konsideratë të nevojave për caktimin e masave të sigurimit kryesisht ndaj individëve të dyshuar për kryerje të veprave penale që janë shqetësuese për komunitetin si “vjedhja”, “shpërdorim detyre”, “kultivim apo mbajtje të lëndëve narkotike” etj. Po ashtu për këto vepra të citura më lart mendoj se ka vend për aplikimin e një politike penale më të ashpër dënimi.

Në raportet e bashkëpunimit institucional me Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër dhe Komisaritet e Policisë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Vau i Dejës kemi qënë të angazhuar për të krijuar një frymë pozitive dhe të ngushtë bashkëpunimi, e cila është e nevojshme në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi, dhe kryesisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimeve të rënda, ku bashkëpunimi i këtyre aktorëve është e nevojshme për të pasur rezultate konkrete. Bashkëpunimi me këto struktura orientohet dhe nga Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Brendshme. Pavarësisht marrëdhënive të mira bashkëpunuese konstatohet se ka zvarritje të afateve të hetimit të procedimeve penale nga ana e policia gjyqësore në policinë e shtetit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Nisur nga veprimtaria dhe kompetenca lëndore e territoriale e kësaj prokurorie, ku hetimi i veprave penale në fushën e kontrabandimit të mallrave apo njerzëve lidhet ngushtë me marrjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve me autoritetet gjyqësore të huaja, në vijimësi kjo prokurori siç u shprehëm më lart ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Marrëdhënive Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë. Ka vend për të rritur komunikimin dhe për të krijuar edhe raporte komunikimi të drejtëpërdrejta për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale sidomos me Autoritetet Gjyqësore të Malit të Zi, etj.

Gjatë këtij viti, nëpërmjet Drejtorisë së Marrëdhënive Juridiksionale me Jashtë janë marrë në shqyrtim dhe ekzekutuar një sërë letër porosish nga Autoritetet e Huaja të Drejtësisë të vëndeve të ndryshme, duke bërë të mundur shqyrtimin dhe ekzekutimin në kohë të tyre, si dhe është kërkuar me letër porosi dhe kërkesa, kryerja e një sërë veprimesh hetimore dhe procedurale jashtë vendit. Po ashtu një raport i vazhdueshëm komunikimi është mbajtur dhe për ekstradimet nga dhe për jashtë vendit.

Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe proaktive

Gjatë këtij viti janë përdorur metoda speciale të hetimit në një numër procedimesh penale, kryesisht në hetimet për mbajtje dhe shitje të lëndëve narkotike, krimet kundër jetës, etj. Ku janë kryer një numër i konsiderueshëm përgjimesh telefonike, ambientale, vëzhgimesh, si dhe në disa raste është aplikuar blerja e simuluar.

Mendoj se këta tregues nuk janë të mjaftueshëm për të luftuar me efikasitet krimin, sidomos krimet e rënda dhe korrupsionin dhe lind si domosdoshmëri përdorimi i metodave speciale të hetimit.

Gjithashtu shqetësim ngelet bashkërendimi i punës mes policisë gjyqësore që ndjek veprimet në terren me qëndrën kombëtare të përgjimeve, ku kjo e fundit në shumicën e rasteve nuk kryen transkriptimin e plotë të bisedave duke sjellë jo efikasitetin e duhur në përdorimin në kohë të këtyre të dhënave.

Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ka qenë e angazhuar pjesërisht në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në zbatim të tyre, në lidhje me këto prioritete;

Në hetimin e veprave penale të korrupsionit ka tregues që flasin për angazhim, por aplikimi i hetimeve historike nuk ka sjellë pritshmëritë dhe rezultatet e duhura, prandaj mendoj se duhet të fokusohemi në rritjen e numrit të hetimeve proaktive në këtë fushë, përdorimit efektiv të metodave speciale të hetimit, ashpërsimin e politikës penale për dënimet, sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive për veprat penale të korrupsionit në kompetencë të kësaj prokurorie.

Në hetimin e veprave penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, pavarësisht regjistrimit të disa procedimeve penale, nuk janë përfituar rezultatet e kërkuara. Duhet angazhim më i madh në këtë drejtim, si për të rritur bashkëpunimin me agjensitë ligjzbatuese brënda dhe jashtë shqipërisë.

Në hetimin e vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore si vrasjet, etj, janë trajtuar ato të ndodhura gjatë këtij viti, por kërkohet më shumë punë në rifillimin e hetimeve për ngjarjet e vjetra të ndodhura për këto grup veprash penale në këtë rreth e për këtë duhet bashkëpunuar me ngushtësisht me policinë e shtetit.

Në hetimin e veprave penale që lidhen me “Vjedhjen e energjisë elektrike” ka një volum pune, por që është fokusuar vetëm ndaj personave fizik, duke anashkaluar hetimet qofshin ato edhe kryesisht të personave juridik, që në vlerësimin tonë shkaktojnë një dëm ekonomik të konsiderueshëm.

Në hetimin e veprave penale që lidhen me “Ndërtimet pa leje”, ka një volum pune, por hetimet edhe këtu janë fokusuar ndaj personave fizik dhe hetimet ndaj personave juridik janë të pakta dhe definacionet përfundimtare të zgjidhjes janë larg pritshmërive.

Në hetimin e veprave penale që lidhen me “mashtrimet në sigurime”, ka një volum të konsiderueshëm pune, por që është fokusuar vetëm ndaj personave fizik, duke anashkaluar hetimet qofshin ato edhe kryesisht të nënpunësve shtetëror që kanë mbajtur dokumentacion e pensioneve në lidhje me bashkëpunimin e tyre, falsifikimin e dokumenteve dhe shpërdorimin e detyrës prej tyre.

Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Lidhur me hetimin e veprave penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, rezulton se kemi regjistruar 20 procedime penale, të dërguara për kompetencë nga Drejtoria e Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Këto raste janë trajtuar me përgjegjësi nga anajonë, ku më poshtë në tabelat përkatëse janë të pasqyruara zgjidhjet që kanë pasur rast pas rasti.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË VOLUMI I PUNËS NË HETIM.

Gjatë vitit 2017, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka funksionuar nën një organizim të ri strukturor, në përputhje me ndryshimet e bëra në ligj.

Më konkretisht, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr.2, datë 19.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimit Nr.3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e e çështjeve në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, është nxjerrë Urdhëri Nr.1 datë 02.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e punës në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”.

Në bazë të urdhërit në fjalë janë krijuar katër seksione të veçanta, e konkretisht:

- a) Seksioni për ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzës në gjykim për veprat penale në fushën e krimit ekonomik-financiar dhe Korrupsionit.
- b) Seksioni për ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzës në gjykim për veprat penale kundër jetës dhe shëndetit të personit dhe kundër rendit dhe sigurisë publike.
- c) Seksioni për ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzës në gjykim për veprat penale kundër pronës dhe pasurisë, mashtrimeve, veprimatrisë shtetërore dhe drejtësisë.
- d) Seksioni për ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzës në gjykim për veprat penale të kryera nga të miturit, veprat penale kundër moralit dhe marrëdhënieve familjare dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.


Kjo ndarje e brëndshme është ndryshuar dhe tashmë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër kemi tre seksione dhe jo katër. Ky veprim është ndërmarrë në funksion të rritjes së efektivitetit dhe cilësisë së punës që do të kryhet nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të caktuar në çdo seksion.

Po ashtu, në këtë kuadër është krijuar Zyra për ekzekutimet dhe kërkesat e tjera në fazën e ekzekutimeve të vendimeve Penale.


Vlerësojmë se kjo ndarje e punës ka shërbyer në profilizimin e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore për një hetim më të mirë të veprave penale në seksionet ku ata janë pjesë. Çmujmë se ka vend për përmirësim të vazhdueshëm në këtë drejtim, pasi konstatojmë se mungojnë politikat penale unifikuese brënda vetë prokurorëve të seksioneve për raste të ngjashme, etj. Po ashtu, ka munguar roli aktiv i shefave të seksioneve qoftë në fazën e hetimit apo gjykimit, e për këtë çmujmë se ka vend për të normuar punën e tyre me nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, duke ruajtur një balancë të drejtë në fazën ku gjendet implementimi i kodit të ri procedural penal ku garantohet pavarësia e prokurorit në fazën e hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, gjatë vitit 2017 ka përballuar një ngarkesë pune të konsiderueshme në ushtrimin e ndjekjes penale, **duke hetuar 3654 çështje penale**, nga të cilat **749 të mbartura** nga vitet e mëparshme, kryesisht viti 2016 dhe **1987 procedime të regjistruara rishtazi**, 13 procedime të rifilluara dhe për 905 çështje penale është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

ÇESHTJET E HETUARA 2017 (3654)



ÇESHTJET E HETUARA 2016 (4526)



Vihet re se numri i procedimeve të regjistruara për vitin 2017 është më i vogël se në vitin 2016 me rreth 210 procedime të reja më pak, nga ato të regjistruara rishtazi. Nga këto procedime janë përfunduar 3044 procedime penale. Për shkak të mbartjes nga vitet e kaluara të një numri të konsiderueshëm dhe atyre të filluara rishtazi, numri i çështjeve të mbartura në vitin 2018 është 730 çështje penale. Në këto procedime duhet të përfshihen edhe 70 bashkime procedimesh. Është vendosur mosfillimi pra për 905 materiale hetimore.

Në përfundim të hetimeve u dërguan për gjykim 1251 çështje, u pushuan 364 procedime, u pezulluan 503 procedime. Në gjyq u dërguan rreth 59 % e numrit të procedimeve të zgjidhura, i cili duhet të konsiderohet tregues i mirë (shih diagramën 2). Gjatë 2017-ës u transferuan për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore 21 procedime.

Ndër grupveprat penale të hetuara, ashtu siç kanë qenë edhe në vitin e kaluar, vazhdojnë t'a zënë ndërtimi i paligjshëm (373 procedime), drejtimi i mjeteve në menyrë të parregullt (190 procedime), krimet e kultivimit të bimëve narkotike (137 procedime), kalimi i paligjshëm i kufirit (70 procedime), falsifikimi i dokumenteve (23 procedime), veprat penale të vrasjes nën 76, 78, 79 Kodit Penal (7 procedime).

III. TREGUESIT STATISTIKOR 1 VJEÇAR TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODITPENAL

Treguesit statistikorë, sipas strukturës së veprave penale të kodit penal, janë paraqitur hollësisht në tabelën përkatëse (shih tabelën sipas strukturës)

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar
Neni 76 Vrasja	3	2	2	2	1	5	2	3	2	3
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër										
Neni 78 Vrasja me paramendim	12	1	1	1	4	10	4	10	4	2
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje										
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese										
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë										
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit										
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare						1		1		
Neni 80						2		1		1
Neni 81 Vrasja e foshnjës										
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike						4	1	7	1	1
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme										
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje						1				
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje										
Neni 84 Kanosja	23	6	6	6	4	13	5	28	9	8
Totali	38	9	9	9	5	36	12	50	16	15

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia						2	2	2	2	1
Totali						2	2	2	2	1

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas										
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.										
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë										
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm						5				
Neni 97 Mosdhënia ndihmë										
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes										
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes						10				
Totali						15				

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2017					2016				
	Nr. Procd . Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia						1		1		
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia						1		1		
Totali						2		2		

KRIME SEKSUALE	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur										
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç						1				1
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura										
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur										
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur										
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërkënim me përdorimin e armës										
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën										
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari						1				
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike										
Neni 108 Vepra të turpshme	1	1	1	1	1	2		2		
Neni 108/a Ngacmim Seksual										
Totali	1	1	1	1	1	4		2		1

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2017					2016				
	Nr. Procd . Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit										
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese	1	1	1	1	1					
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise						1		2		
Neni 109/c Zhdukja me forcë										
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	1	1	1	1	1	4	4	14	6	2
Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera										
Neni 112 Dhunimi i baneses						3		2		1
Totali	2	2	2	2	2	8	4	18	6	3

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITËTIT	2017					2016				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proc ed per gjy kim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pan d den uar
Neni 113 Prostitucioni										
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	2					3		5		
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion	2									
Neni 117 Pornografia										
Neni 118 Dhunimi i varreve						2				
Neni 119 Fyerja										
Neni 120 Shpifja										
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private	2					2				
Neni 121/a Përndjekja	3	1	2	1	1	1				
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake										
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës										
Totali	9	1	2	1	1	8		5		

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESES DHE FAMILJES	2017					2016				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denu ar
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur						2		1		
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit						5	2	11	2	1
Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë										
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit	1					1		1		
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës	1									
Neni 128 Ndërrimi i fëmijëve										
Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje I fëmijës										
Neni 129 Shtytja e të miturve në krim										
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë										
130/a Dhuna në familje	104	40	55	40	40	65	33	87	35	25
Totali	106	40	55	40	40	73	35	100	37	26

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denua r
Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare										
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit										
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare										
Totali										

VJEDHJA E PASURISË	2017					2016				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 134 Vjedhja	410	132	79	132	69	381	63	162	92	64
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	10	5	7	5	5	5	1	7	3	
Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursim.										
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	212	168	144	168	56	135	87	168	87	71
Neni 137 /aVjedhja e rrjetit te komunikimeve elektronike										
Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës										
Neni 139 Vjedhja me dhunë	11	6	5	6	5	7	1	7	1	
Neni 140 Vjedhja me armë						4	1	8	1	1
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen						10	2	13	5	3
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje										
Totali	643	311	235	311	135	542	155	365	189	139

MASHTRIMET	2017					2016				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand . Per gjyki m	Nr. Pand denu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denu ar
Neni 143 Mashtrimi	21	4	3	4	1	26	10	26	13	7
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale										
Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut										
Neni 143/a/2 Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar										
Neni 143/a/3 Manipulimi i cmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë										
Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre										
Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar										
Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë										
Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve										
Neni 144 Mashtrimi në subvencione										
Neni 144/a	6	5	10	5	5					
Neni 145 Mashtrimi në sigurime	39	25	39	25	25	95	88	100	88	100
Neni 146 Mashtrimi në kredi										
Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës										
Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet										
Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit										
Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale	4	2	2	2						
Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërcuesit										
Totali	70	36	54	36	31	121	98	126	101	107

SHKATËRRIMI I PRONËS	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd . Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	11	7	6	7	1	15	2	13	2	1
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	13		3			12		4		
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	3					1				
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmytje										
Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera										
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve										
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik										
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes										
Neni 158										
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit										
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore										
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	2		1			3		2		
Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv										
Totali	29	7	10	7	1	31	2	19	2	1

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denua r
Neni 163 Përpilimi i deklaratave të rreme										
Neni 164 Shpërdorimi i kompetencave										
Neni 165 Falsifikimi i nënshkrimeve										
Neni 166 Emetimi i parregullt i aksioneve										
Neni 167 Mbajtja e padrejtë e dy cilësive										
Neni 168 Dhënia e informacioneve të rreme										
Neni 169 Zbulimi i sekreteve të shoqërisë										
Neni 170 Mosbërja e shënimeve të detyrueshme										
Neni 170/a Punësimi i paligjshëm	3		3			2		2		
Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës										
Totali	3		3			2		2		

V.P. NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE E FINANCIARE	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 170/c										
Neni 170/ç	13	1	8	1		7	3	10	3	3
Totali	13	1	8	1		7	3	10	3	3

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denua r
Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar										
Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	4		2			18	7	11	9	7
Neni 173 Kontrabanda me mallra të licencuar										
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	7	3	5	3	4	3	1	6	1	2
Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore										
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore										
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	4	1	1	1		3	2	4	2	6
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	9	8	8	8	3	10	8	14	12	10
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë	1	1	1	1	1	2		3		
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë						2	1	3	1	1
Neni 179/b Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë së autoriteteve doganore										
Neni 179/c Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet										
Neni 179/ç Kontrabanda e kapitenit, pilotit ose ekuipazhit										
Totali	25	13	17	13	8	38	19	41	25	26

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET	2017					2016				
	Nr. Proecd Regj	Nr. proecd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proecd Regj	Nr. proecd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	36	15	36	15	15	44	25	63	26	15
Neni 180/a	1	1	1	1						
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	2									
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore										
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse										
Neni 182/a										
Totali	39	16	37	16	15	44	25	63	26	15

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË	2017					2016				
	Nr. Proecd Regj	Nr. proecd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proecd Regj	Nr. proecd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 183 Falsifikimi i monedhave	2	1	1	1		5	3	4	4	3
Neni 184 Falsifikimi i letrave me vlerë										
Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim										
Totali	2	1	1	1		5	3	4	4	3

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	56	14	14	14	5	53	8	12	8	3
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore						3	2	4	2	1
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore						1		2	2	
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	21	11	7	11	4	30	10	15	10	6
Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	20	6	8	6		2	1	1	1	
Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile										
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve										
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve						1	1		1	
Totali	97	31	29	31	9	90	22	34	24	10

ZHVILLIMI I PALEJUARI LOJËRAVE TË FATIT	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 197 Organizimi i llotarive te palejuara	32	18	18	18	18	19	12	33	12	11
Neni 197/a Paracaktimi i rezult. Ne garat sportive										
Neni 197/b Shtremberimi i konkurences ne garat sportive										
Neni 198 Venia ne dispozicion e lokaleve per lojra te palejuara										
Totali	32	18	18	18	18	19	12	33	12	11

REGJIMI JURIDIK I TOKËS	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	1					2		1		
Neni 199/a Ndertimi i paligjshem	407	207	207	207	5	125	84	223	84	54
Neni 199/b										
Neni 200 Pushtimi i tokës	5					5	1	2	1	2
Totali	413	207	207	207	5	132	85	226	85	56

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denua r
Neni 201 Ndotja e ajrit										
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike										
Neni 203 Ndotja e ujërave						2		1		
Neni 204 Peshkim i ndaluar	3	2	2	2	2	8	5	8	8	4
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	10	3	3	3	2	14	2	7	2	1
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë						1				
Neni 206/a Shkaterrimi me zjarr i pyjeve										
Neni 206/b Shkaterrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve										
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve										
Totali	13	5	5	5	4	25	7	16	10	5

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	20	10	10	10	9	18	13	25	21	11
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës						4	2	3	2	3
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	4	1	1	1	1	5	2	3	2	
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik	26	2	8	2	1	15	10	21	12	9
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore										
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore										
Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar										
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës										
Totali	51	14	20	14	12	43	28	53	38	24

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pan d. Per gjk im	Nr. Pand denu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjkim	Nr. i pand · Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denu ar
Neni 248 Shperdorim detyre	85	45	86	45	20	80	11	184	28	4
Neni 248/a Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore										
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhenies fund te tij										
Neni 70 KPU Shperdorim detyre										
Neni 250 Kryerja e Veprimeve arbitrare	1									
Neni 251 Mosmarrja e masave per te nderprere gjendjen e paligjshme										
Neni 252 Mbajtja ne burg pa vendim										
Neni 253 Shkelja e barazise se shtetasve										
Neni 254 Shkelja e paprekshmerise se baneses										
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtesise se korrespondences										
Neni 256 Shperdorim i kontributeve te dhena nga shteti	1									
Neni 257 Perfitim i paligjshem i interesave	3									
Neni 257/a Refuzimi per deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë	2					6	2	3	2	1
Neni 258 Shkelja e barazize ne tendera apo ankande publike	1									
TOTALI	93	45	86	45	20	86	13	187	30	5

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	2									
Neni 271 Disinformimi i ekepeve të urgjencës										
Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit	13	5	13	5	2	4	2	5	2	2
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	8	1	2	1	2	4	2	1	2	3
Neni 274 Prishja e qetësisë publike	1					6	3	4	4	3
Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrj. telefonike	18	2	2	2		12				2
Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq										
Neni 277 Vetëgjyqësia	12	2	8	2	2	10	2	4	3	1
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit	42	10	14	10	18	44	22	34	23	29
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta	3	3	3	3	1	5	4	3	4	4
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjuetisë dhe sportive	1					6	2	3	2	2
Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industr. dhe ushqimorë	2		1			8	6	9	6	4
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	1					5		6		
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	128	62	85	62	62	57	9	32	9	12
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	239	181	185	181	121	308	272	335	273	228
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit										
Totali	470	266	313	266	208	463	324	436	328	290

PRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denua r	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denua r
Neni 300 Moskallzimi i krimit	1	1	3	3	3	2	1	3	6	6
Neni 301 Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës	1									
Neni 302 Përkrahja e autorit të krimit						1		1		
Neni 303 Fshehja ose asgjësimi i kufomës										
Neni 304 Detyrimi për të kallzuar provën										
Neni 305 Kallzimi i rremë	2		1			3	2	2	3	
Neni 305/a Deklaratat e rreme përpara prokurorit										
Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara of.pol.gjyq.	1		1			2	2	2	2	3
Neni 306 Dëshmia e rreme	2		2			2	2	3	9	7
Neni 307 Refuzimi për të dëshmuar										
Neni 308 Përkthimi i rremë										
Neni 309 Ekspertimi i rremë	1									
Neni 314 Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve						1				
Neni 316 Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit										
Neni 317 Kanosja e gjyqtarit						4				
Neni 318 Fyerja e gjyqtarit	1									
Neni 320 Pengime për ekzekutimin e e vendimeve të gjykatës										
Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës	3	1	3	1	1	2	2		3	1
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës	3	1	3	1	1	2	2	2	2	3
Totali	15	3	13	5	5	19	11	13	25	20

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHTETËRORE	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denua r
Neni 294 Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar										
Neni 295 Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit										
Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete										
Neni 296 Humbja e dokumenteve sekrete										
Neni 297 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	97	45	45	45		50	32	92	37	37
Neni 298 Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit	7	2	3	2	2	9		5		4
Neni 299 Shkelja e rregullave mbi fluturimet										
Totali	104	47	48	47	2	59	32	97	37	41

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT	2017					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjyki m	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand . Per gjyki m	Nr. Pand denua r	Nr. Procd Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denua r
Neni 124/a Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit										
Neni 164/a Korrupsion aktiv në sektorin privat										
Neni 164/b Korrupsion pasiv në sektorin privat	1									
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	11	6	6	6	6					
Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë						7		7	2	
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë										
Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	2	1	1	1	1	1				1
Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike	3		2			2	1	3	1	
Neni 328 Dhenia e shpërblimeve dhe e premtimeve	1	1	1	1						
Totali	18	8	10	8	7	10	1	10	3	1

KRIMI KIBERNETIK	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro genocitit ose krimeve kunder njerëzimit										
Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. kompj.										
Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik	1					4				
Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik	1									
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik										
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik										
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike	7					4				
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike										
Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve										
Totali	9					8				

TRAFIKIMI	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 110/a Trafikim i Personave										
Neni 128/b Trafikimi i të miturve										
Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës										
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	20	3	15	3	1	12	1	20	1	
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit										
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive										
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve						1		1		
Totali	20	3	15	3	1	13	1	21	1	


PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2017					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	111	53	69	53	51	73	33	188	48	23
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	311	42	47	42	24	324	15	344	22	7
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale										
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope										
Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i sustancave kimike						2	2	2	2	1
Totali	422	95	116	95	75	399	5	534	72	31

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SHKALLËS PARË SHKODËR

TABELA 1


ORIGJINA E PROCEDIMEVE TË REGJISTRUARA

N r .	MËNYRA E REGJISTRIMIT	Numri i Procedime ve
1	Me vendngjarje	130
2	Ardhur me transferim nga prokurorite e rretheve	70
3	Kallëzime nga shtetasit	60
4	Referime nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër	2507
5	Referime nga Polici te tjera	71
6	Regjistruar kryesisht ose me urdhër të Prokurorisë së Përgjithshme	6
7	Kallzime nga Nenpunesit Publik	142
TOTAL		2986



- Mosfillimet e procedimeve penale gjatë vitit 2017.**

Nga studimi i të dhënave statistikore, rezulton se gjatë vitit 2017 është vendosur mosfillimi për 905 materiale kallzuese apo të referuara, të cilat në krahasim me numrin e rasteve të mosfilluara në vitin 2016 është më i lartë (868). Nga këto, shumë raste të mosfillimit të procedimeve penale, një pjesë e konsiderueshme janë mosfilluar për veprën penale të “Shkeljes se rregullave të qarkullimit rrugor”, “Shkaktimit e vetëvrasjes”, “të demtimeve të tjera me dashje”, “shkatërrim i pronës dhe “Fallsifikimit të dokumentave”, “shperdorim detyre”, “vetëgjyqesi”, “prerje paligjshem pyjeve”, “pushtim toke”, “Ndërtim i paligjshëm”, “shkatërrim i pronës me zjarr”, etj., vepra këto të parashikuara nga nenet 290, 90,150, 151, 248, 277 , 205, 200, 199/a/1 dhe 186 te Kodit Penal.



Në 16 raste nuk është miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë vendimi i mosfillimit dhe është urdheruar fillimi i procedimit penal, në periudhën para se të hynin në fuqi ndryshimet e kodit të procedurës penale dhe ligjit për Prokurorinë. Ky tregues pasqyron në mënyrë të qartë se vleresimi i materialeve të referuara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, para se të urdherohet regjistrimi i tyre si çështje penale ka qenë profesional, i plotë dhe ligjor.

Në total nga 905 materiale kallezimi të mosfilluara, janë ankimuar në gjykatë 44 vendime mosfillimi dhe në 24 raste Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të mosfillimit dhe ndaj këtij vendimi në 9 raste është ushtruar ankim dhe çështja ndodhet në Gjykatën e Apelit. Në 12 raste Gjykata ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit, ku prej tyre në 11 raste është ushtruar ankim nga prokurori në Gjykatën e Apelit dhe çështjen ndodhen në shqyrtim. Në 4 raste është vendosur nga gjykata pushimi i gjykimit. Në 1 rast është vendosur rigjykimi i çështjes dhe për 3 raste të tjera çështjet janë në shqyrtim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në të gjitha rastet është bërë vleresimi i duhur i materialeve të kallzuara, në pjesën më të madhe të tyre janë kryer dhe veprime në kuadrin e verifikimeve, dhe pas vendimarrjes për mosfillimin e çështjes në të gjitha rastet është respektuar njoftimi i kallzuesit apo paleve që kanë të drejtën e marrjes së dëgjimit.

- **Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2017.**

Gjatë vitit 2017 janë pezulluar për moszbulim të autoreve 503 çështje penale, të cilat në krahasim me numrin e çështjeve të pezulluara në vitin 2016 janë më pak. Pjesa më e madhe e të cilave kanë qenë të regjistruara për veprën penale të “Kultivimit të Bimëve Narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal.

Ka pësuar rritje pezullimi tek çështjet penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga Neni 134 nga 211 çështje të vitit 2016, në 220 për vitin 2017. Kjo tregon rënie të zbulueshmërisë së autoreve të kësaj vepre penale, duke evidentuar faktin se vazhdon të jetë shqetësuese cilësia e hetimit të kësaj vepre penale dhe duhet të bëhen përmirësime të ndjeshme në vitin në vijim.

- **Procedimet penale të pushura gjatë vitit 2017.**

Gjatë këtij viti është vendosur pushimi për 364 çështje penale, të cilat në krahasim me numrin e çështjeve të pushuara në vitin 2016 janë më pak. Nga këto 364 raste të pushimit të çështjeve penale, një pjesë e konsiderueshme e procedimeve, janë pushuar pasi është parashikuar vepra penale, ku pjesën më të madhe e zë vepra penale e vjedhjes së pasurisë, kemi një pjesë të konsiderueshme pushime të çështjes penale në hetim, si dhe pushime të disa procedimeve penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 134, 186, 199/a, 248, 290/2, etj.

Nga totali i çështjeve të pushuara, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor janë ankimuar 41 çështje. Gjykata në përfundim të shqyrtimit në 8 raste ka pranuar kërkesën për prishjen e vendimit të pushimit, në 17 raste ka rrëzuar kërkesën, në 6 raste është vendosur pushimi i Gjykimit, në 2 raste është vendosur rigjykimi, në 8 raste kërkesat janë në shqyrtim nga Gjykata.

Gjatë vitit 2017 rezultoi se janë rifilluar 13 procedime penale nga keto janë rifilluar procedime penale të pushuara dhe procedime të pezulluara. Kryesisht këto çështje janë rifilluar pasi pjesa më e madhe e tyre ishte pezulluar për leterporosi të shteteve të huaja dhe rifillimi është bërë me ardhjen e pergjigjeve nga autoritetet e huaja.

Në shumë raste, veprimet e para hetimore, si kqyrja e vendit të ngjarjes, zbulimi, fiksimi dhe marrja e gjurmëve dhe provave materiale që kanë lidhje me zbulimin e mekanizmit dhe autorëve, kanë qënë jo të plota dhe të kryera me mangësi të theksuara profesionale, që kanë ndikuar drejtëpërdrejtë edhe në mënyrën e përfundimit të çështjes.

- **Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2017**

Rezultoi se gjatë këtij viti janë transferuar në drejtim të prokurorive të tjera 21 çështje penale, për vepra të ndryshme penale.

Kryesisht vendimet në lidhje me shpalljen e moskompetences dhe kalimit të akteve janë arsyetuar drejtë, janë marrë në një kohë të shpejtë menjehere pas konstatimit të faktit të moskompetences duke i kaluar aktet prokurorive perkatase.

- **Çështjet penale të gjykuara gjatë vitit 2017.**

Gjatë këtij viti janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër 1251 çështje penale, janë më shumë në krahasim me çështjet penale të trajtuara se gjatë vitit 2016 (1202 çështje). Pjesën më të madhe e zene çështjet penale të rregjistruara për veprat penale të Mashtrim me sigurimet neni 145, Vjedhje neni 134, Drejtim Mjeti në mënyrë të Parregullt neni 291, Nderim i paligjshëm neni 199/a, Dhune në familje neni 130/a, Mbajtjes pa leje të armëve luftarake neni 278, Vjedhje të energjisë elektrike neni 137, Kalim i Paligjshëm i Kufirit neni 297 i kodit penal, etj.

Me konkretisht treguesit e gjykimit të çështjeve penale janë si më poshtë;

Totali i çështjeve të gjykuara	Gjykim i drejtpërdrejtë	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshem
882	70	768	44

- Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë është kërkuar denimi i të pandehurve si më poshtë: 374 raste është kërkuar minimumin i denimit, 113 raste mesatare e denimit, 10 raste maksimumi, denim me kusht sipas nenit 59 janë kërkuar 391 raste si, denim me gjobe 10 raste. Gjatë vitit 2017, në masën e denimit me burg nga ana e Prokurorisë është kërkuar, në disa raste, zëvendësimi i denimit me burg me nenin 63, 53/a, 59/a të K.Pr.Penale gje e cila është vendosur dhe nga Gjykata.
- Nga ana e gjykatës janë vendosur keto masa denimi si më poshtë: denim me gjobe 10 raste, denim minimum në 294 raste, denim mesatar në 66 raste, denim maksimal në 2 raste, denim me kusht sipas nenit 59 të K.Penal në 526 raste.

- Ne vijim te kesaj pike po japin nje permbledhje te kerkesave per denimin te organit te prokurorise dhe vendimet e marra prej gjykates lidhur me keto kerkesa:

Treguesit e menyres se perfundimit te gjykimit te ceshtjeve penale te trajtuara gjate vitit 2017.

Gjate vitit 2017, nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder jane perfunduar gjykimet e 882 ceshtjeve penale, prej te cilave: 70 ceshtje me gjykim te drejteperdrejte me 70 te pandehur, 44 ceshtje me gjykim te zakonshem me 42 te pandehur, 762 ceshtje me gjykim te shkurtuar me 772 te pandehur. Gjithashtu në 10 raste është aplikuar gjykimi me urdhër penal dhe në 15 raste është aplikuar gjykimi me marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Treguesit e te pandehurve ne ceshtjet penale te trajtuara gjate vitit 2017.

Gjate vitit 2017, nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder jane marre ne cilesine e te pandehurit 1531 shtetas me 1857 persona nen hetim, nga te cilet 1275 te pandehur jane derguar per gjykim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder ku 402 prej tyre ne gjendje arresti ne burg, per 150 persona nen hetim dhe 6 pandehur është pushuar çeshtja apo akuza, Per te pandehurit e tjere ose personat nen hetim vazhdojne hetimet paraprake.

Treguesit e masave te sigurimit ne ceshtjet penale te trajtuara gjate vitit 2017.

Gjate vitit 2017, ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Shkoder jane referuar nga policia gjyqesore 503 arrestime ne flagrance, 35 ndalime si dhe 8 ndalime me urdher te prokurorit. Lidhur me kete persona te arrestuar dhe ndaluar nga ana e prokurorise jane perpiluar ne total dhe kerkuar ne gjykate 307 arrest ne burg, 4 arrest ne mungese, 17 arrest ne shtepi, 8 arrest me afat, 4 garanci pasurore dhe 163 detyrim per paraqitje. Nga ana e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder ne lidhje me kerkesat tona jane vendosur keto masa sigurimi: 246 arrest ne burg, 4 arrest ne burg ne mungese, 35 arrest ne shtepi, 30 arrest ne burg me afat 8 garanci pasurore, 180 detyrim per paraqitje.

Ne lidhje me keto kerkesa nga ana e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder eshte vendosur ne shumicen e tyre pranimi si te bazuara ne ligjin procedural penal dhe provat e administruara. Ne cdo rast kur nuk eshte perkrahur kerkesa jote eshte ushtruar apel sipas ligjit procedural penal.

Me konkretisht treguesit e masave te sigurimit personal dhe pasuror jane si me poshte;

Totali i arresteve/ndalimeve	Lirim i menjehershëm Neni 257	Kerkesa e prokurorise Neni 258	Vendimi i gjykates Neni 259
Vleftesime te ligjshme			448
Vleftesime te paligjshme			4
Lirime menjehershme			

Arrest ne burg		212	153
Arrest me afat		7	7
Arrest ne shtepi		49	51
Detyrim paraqitje		180	237
Arrest burg ne mungese		2	2
Masa ndaluese			
Neni 239 K.Pr.Penale			
Garanci pasurore		2	2

Shpejtësia në hetime, dhe zgjatja e afatit të hetimeve paraprahe gjate vitit 2017.

Gjate vitit 2017 rezulton se një pjesë e këtyre e çështjeve penale të regjistruara te reja jane perfunduar brenda afatit ligjor dhe kryesisht për çështje penale me persona te arrestuar ne hetim.

Lidhur me nje ndarje te grup veprave ne te cilat eshte marre vendim per zgjatjen e afatit te hetimeve paraprahe, rezulton se per veprat penale kunder personit jane marre 25-vendime zgjatje afati; 35 vendime janë marrë per vepra penale kunder pasurise; 4 vendime jane marre per veprat penale kundër autoritetit të shtetit. Pjesa me e madhe e zgjatjeve eshte marre ne hetimin e ceshtjeve te njesise se perbashket te hetimit, nisur kjo nga natyra e veprave penale qe heton kjo njesi si dhe e veprimeve te shumta hetimore qe del e domosdoshme per hetimin.

Apelimet e bëra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër gjatë vitit 2017.

Gjate vitit 2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë paraqitur në gjykate në total 194 apelime për vendime përfundimtare të gjykatës. Këto apelime janë ushtruar kundër vendimeve gjyqësore për të cilat nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë dhënë vendime pafajesije dhe pjesa tjetër janë bërë kundër vendimeve gjyqësore per te cilat nga gjykata ka patur ndryshime te raportit per masen e demimit nga kerkesa e Prokurorit dhe Vendimit të Gjykatës. Po keshtu, jane paraqitur edhe 100-apele për masa sigurimi personal nga ana e prokurorit.

Ngarkesa e punës së Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2017.

Gjate vitit 2017, nga ana e prokurorëve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkoder është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme çështjes penale dhe zhvillime gjykimesh pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Shkoder. Ashtu sic edhe e kemi trajtuar në pikën e parë të këtij raporti, rezulton se nga prokuroret është hetuar dhe përfunduar nje numer i madh çështjes penale.

Me konkretisht po japin në një tabelle përmbledhëse të dhënat e ngarkeses së secilit prokuror dhe menyren e përfundimit të çështjeve prej tyre.

Prokuror	Nr.Proc	Perfunduar	Derg.Gjyq	Pezulluar	Pushuar	Derg.Komp	Bashk.Proc	Ne Hetim
A.Halilaj	132	101	45	31	20	1	4	31
A.Murçaj	93	88	61	11	15	1		5
A.Smaçi	344	247	136	82	12	2	15	97
B.Hamza	125	84	45	5	30	2	2	41
E.Cufi	212	117	62	43	12			95
E.Lelçi	306	247	130	85	20	1	11	59
F.Laloshi	229	181	125	26	22		8	48
F.Lekani	148	110	70	21	15	2	2	38
L.Çardaku	201	170	110	32	21	1	6	31
M.Frasheri	104	80	62	10	5	1	2	24
S.Bahiti	96	72	45	3	20	2	2	24
Sh.Milla	226	178	80	50	33	4	11	48
V.Staka	251	233	131	59	40	1	2	18
Xh.Lita	108	82	51	9	20	1	1	26
E.Ndoci	126	84	46	10	25	2	1	42
S.Mestani	100	73	50	20	3			27
M.Shtjefni	18	12	2	6	1		3	6
Total	2819	2159	1251	503	314	21	70	660

Gjate vitit 2017 edhe oficeret e policise gjyqesore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër kanë patur një ngarkesë të konsiderueshme. Më poshtë po japin në një tabelë përmbledhese të dhenat e ngarkesës së secilit prej oficerëve të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër:

Nr.	Oficeri Pol. Gjyqesore	Totali i ceshtjeve
1	A.Fejzullari	135
2	B.Vujoshi	95
3	D.Bilali	65
4	E.Myrtaj	78
5	K.Como	82
6	K.Livalli	118
7	L.Tusha	110
8	N.Bajrakurti	82
9	S.Doda	77
10	S.Kerxhaliu	121
11	F.Vata	126

Ekzekutimet e vendimeve penale.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për ekzekutimet e vendimeve penale gjatë vitit 2017 ka qënë i ngarkuar prokurori z.Agron Bushati.

Gjate vitit 2017 janë vënë në ekzekutim të gjitha vendimet penale të formës së prerë duke respektuar afatet ligjore të parashikuar në nenin 49 të ligjit Nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar. Janë lëshuar 1994 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale, e konkretisht; 145 vendime me burg, 93 vendime me gjobe, 544 vendime sipas nenit 59 të K.Penal, 15 vendime sipas nenit 59/a dhe dhe 82 vendime sipas nenit 63 të K.Penal. Nga këto urdhëra të nxjerre janë ekzekutuar; 110 vendime me burg, 68 vendime me gjobë, 13 vendime sipas nenit 59/a të K.Penal, 69 vendime sipas nenit 63 të K.Penal dhe 659 vendime sipas nenit 59 të K.Penal.

Nga ana e sektorit të ekzekutimit të vendimeve penale është bërë një punë e mirë lidhur me nxjerrjen e urdhërave të kërkimit ndërkombëtar në zbatim të kërkesave të reja ligjore që kanë sjelle ndryshimet e legjislacionit në këtë

fushë. Kështu në zbatim të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit nga kjo prokurori janë nxjerrë disa udhëra për kërkim ndërkombëtar.

Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë gjatë vitit 2017.

Gjate vitit 2017, rezulton se ka patur një ngarkesë të konsiderueshme pune edhe në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja dhe konkretisht;

- Gjatë këtij viti janë dërguar për jashtë shtetit 50 kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale;
- Janë ekzekutuar 62 kërkesa për ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja të dërguara nga ana jonë si gjatë vitit 2017 dhe gjatë viteve të mëparshme;
- Nga autoritet gjyqësore të huaja, kanë ardhur për t'u ekzekutuar 39 kërkesa për ndihmë juridike, ku 21 kërkesa janë ekzekutuar deri tani, për 1(një) kërkesë është vendosur mospranimi, ndërsa të tjerat janë në proces.
- Janë dërguar 7 kërkesa për ekstradim të kërkuara nga autoritet gjyqësore të huaja pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku 4 prej të cilave është vendosur pranimi i ekstradimit.
- Ka pasur 7 kërkesa në për njohje të vendimeve penale të dhëna nga autoritet gjyqësore të huaja të cilat janë në proces.
- Për 7 raste është kërkuar shpallja e kërkimit ndërkombëtar nga ana e Prokurorëve, ku 2 prej të cilëve janë ekzekutuar.

Edhe në këtë drejtim mbetet për të punuar më shumë dhe konkretisht;

- Rritja e cilësisë së kërkesave për ndihmë juridike në fushën penale nga prokurorët si dhe njohja më mire e legjislacionit që rregullon këto marrëdhënie.
- Vërehet se kërkesat për ndihmë juridike formulohen me vonesë nga momenti i evidentimit të nevojës për një kërkesë të tillë, nuk ka komunikime vazhduese me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë si në Prokurorinë e Përgjithshme apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë si dhe nuk shfrytëzohen sa duhet komunikimet direkte me autoritet e huaja apo oficerët ndërlidhës pranë ambasadave në Tiranë kur është mundësia.
- Konstatohet se disponohet në shumë raste gabim me pezullimin e hetimit për shkak të vonesave lidhur me ekzekutimin e letërporosisë si dhe ka neglizhenca të theksuara në rifillimin e hetimeve pasi ekzekutohen këto letërporosi, etj.

Administrimi i Prokurorisë

Në mbarëvajtjen e punës së veprimtarisë së Prokurorisë një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata. Rezulton se gjatë vitit 2017 është punuar në përmirësimin e punës së mbajtjes së regjistrave dhe raportimeve periodike të statistikave të Prokurorisë. Gjithashtu është punuar për vënien në zbatim të sistemit CAMS. Mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim, për të pasur një evidentim të plotë të të gjithë treguesve të kërkuar dhe rritjen e performancës së punonjësve të ngarkuar me këto veprime. Po ashtu, rezulton se gjendja e administrimit të dosjeve në arkiv nuk është në nivelin e kërkuar, e për këtë kemi filluar të marrim masa në këtë drejtim, duke nxjerrë urdhërat përkatës dhe planifikuar disa investime brenda buxhetit tonë.

Problem tjetër i konstatuar gjatë kësaj periudhe mbetet administrimi i provave materiale, pasi në shumë raste evidentohen qëndrime jo korrekte të prokurorëve mbi disponimin rreth tyre, si gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjeve. Kemi konstatuar se në dhomën e provave në Prokurori, gjenden prova materiale të viteve të fundit që fillojnë nga viti 2013 e në vijim, për të cilat nuk ka asnjë disponim edhe pse hetimi dhe gjykimi i tyre ka përfunduar. Së shpejti këtë situatë mendojmë ta stabilizojmë, pasi po punojnë për nxjerrjen e urdhërave dhe udhëzimeve përkatëse.

Përsa i përket respektimit të disiplinës në punë dhe të Etikës nga ana e punonjësve të kësaj Prokurorie,

mendoj se ka vend për përmirësime dhe mbetet për të punuar më shumë në këtë drejtim.

Lidhur me anën financiare institucioni jonë është përpjekur për të qënë korrekt në zbatimin e ligjit dhe mirë administrimin e fondeve buxhetore. Mendojme se shtimin i buxhetit për disa zëra do të ndihmonte në punën e prokurorisë pasi për një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm kërkohen njohuri nga ekspertë të fushave të ndryshme, përkëthyes, psikologe, ku angazhimi i tyre shton shpenzimet, etj.

V. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME.

- Për vitin 2018, mbetemi të angazhuar për përmbushjen me korrektësi të detyrave kushtetuese dhe ligjore, duke bërë përpjekje për përmirësimin dhe përsosmërinë e mëtejshme në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim.
- Në vëmendje të punës tonë të përditshme do të kemi parasysh dhe do të zbatojmë të gjitha prioritetet dhe objektivat e hartuara nga Prokurori i Përgjithshëm që kanë të bëjnë me forcimin e hetimit të kriminalitetit dhe paligjshmërisë.
- Krijimin e kushteve dhe sigurimin e mbështetjes së nevojshme në garantimin e ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, në pavarësi të plotë të prokurorëve, parë kjo ngushtësisht në një fazë të re të krijuar nga ndryshimet thelbësore që ka pësuar drejtësia penale nga reformat e fundit në këtë fushë.
- Trajnimi i prokurorëve dhe of.pol.gjyqësore, nxjerrja e urdhërave dhe udhëzime me qëllim ardhjen në ndihmë për implementimin sa më të plotë dhe të drejtë në praktikë, të ndryshimeve që ka pësuar kodi i procedurës penale apo ligje të tjera të drejtësisë penale gjatë kohëve të fundit.
- Fuqizimi i seksioneve të krijuara pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas grup veprave penale, bashkërendimi i punës midis tyre, përcaktimi i detyrave dhe roleve të drejtuesve të seksioneve me qëllim vlerësimin, ndjekjen, grumbullimin e provave dhe hetimin më cilësor të procedimeve penale.
- Rritjen e bashkëpunimit, kryesisht me policinë e shtetit si një hallkë shumë e rëndësishme në luftën kundër kriminalitetit. Për këtë, mendojmë se seksionet e krijuara në prokurori duhet të jenë bashkëvepruese me strukturat përkatëse në policinë e shtetit sipas grup veprave penale që ndjekin me qëllim rritjen e efikasitetit të ushtrimit të ndjekjes penale.
- Prioritet i punës tonë mbetet ndërtimi i një bashkëpunimi më konkret me strukturat e hetimit tatimor dhe doganor dhe me drejtorinë e parandalimit të pastrimit të parave, pasi bashkërendimi i të dhënave dhe shfrytëzimi i aseteve dhe i informacioneve që këto agjensi kanë në punën e tyre të përditshme, mendojmë se shërben si një bazë e mirë të dhënash për hetimin me sukses të veprave penale në fushën e tatimeve, doganave, pastrimit të produkteve të vepres penale, etj.
- Një prioritet tjetër për ne është shfrytëzimi i të dhënave që kanë rregjistrat kombëtar të pasurive (siç janë ZVRPP, Aluizni, DRSHTRR, QKR, etj) dhe mundësia e marrjes së këtyre të dhënave prej tyre, në mënyrë të drejtëpërdrejtë (online) apo në një kohë sa më të shpejtë, kjo me qëllim kryerjen e një hetimi penale të plotë, të gjithëanshëm dhe objektiv.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar, qoftë i drejtëpërdrejtë aq sa është e mundur por, edhe duke shfrytëzuar raportet me drejtorinë e marrëdhënive juridiksionale me jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme në hetimin e veprave penale, kryesisht të trafikimit të mjeteve motorrike, dhënies ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufirit, pastrimit të parave dhe kontrabandimit të mallrave, e vlerësojmë si prioritet të punës sonë në vijim.
- Vlerësojmë se rritja e numrit të hetimeve proaktive, sidomos në veprat penale të korrupsionit, mbajtjes dhe shitjes së narkotikëve, shfrytëzimit të prostitucionit, pastrimit të produkteve të vepres penale, të ushtrimit pa licensë të veprimtarisë bankare (dhënies së parave me fajde), etj, është rruga e duhur për

të pasur një qasje më produktive kundër këtyre fenomeneve kriminale dhe shqetësuese për rajonin e Shkodrës.

- Ushtrimi i ndjekjes penale kryesisht për shumë vepra penale të cilat nuk janë referuar në prokurori gjatë vitit 2017, por fenomeni apo fakti penal ekziston, mbetet një ndër prioritetet kryesore të punës tonë në vijim.
- Qasja drejt një bashkëpunimi më produktiv me gjykatën, për aq sa është e mundur, për sigurimin e një menaxhimi më të mirë të kohës së prokurorëve, në lidhje me shqyrtimin e disa kërkesave që fillojnë nga faza e hetimit paraprak deri në përfundimin e çështjeve si rezultat i ndryshimeve që ka pësuar kodi i procedurës penale.
- Nxitja e prokurorëve për vënien në zbatim të institutive të reja të procedurës penale, si urdhëri penal dhe gjykimi me marrëveshje, çojmë se do ti shërbejë efikasitetit dhe shkurtimeve të kohës në gjykimin e rasteve të caktuara.
- Mendojmë se duhet shfrytëzuar më mirë dhe efikasitet hapësira që është krijuar qoftë me ligjin procedural apo edhe me ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve apo bashkëpunëtorëve të drejtësisë për të pasur marrëveshje bashkëpunimi me persona të penduar apo duke siguruar dëshminë e shtetasve të cilët gjenden nën kërcënim nga subjekte që kanë konsumuar vepra penale të rënda.
- Angazhohemi që numrin e madh të çështjeve të mbartura nga viti i kaluar, të mund t'i përmbysim në një kohë sa më të shkurtër. Njëkohësisht të bëjmë përpjekje qoftë nga trajnimet që mund të bëjmë me kapacitetet tona trajnuese apo me trajnimet vazhduese të Shkollës së Magjistraturës apo institucioneve të tjera që veprojnë në këtë fushë, të rrisim cilësitë tona të hetimit në kuptim të një niveli profesional më të lartë për sa i takon hartimit të akteve procedurale.
- Sfidë mbetet rritja e besimit tek publiku, pasi të gjithë indikatorët flasin për një nivel jo të kënaqshëm që kanë qytetarët në drejtësinë penale, ku bën pjesë edhe prokuroria. Për këtë, synojmë që jo vetëm shpejtësia dhe cilësia e hetimit, por edhe transparenca ndaj publikut do të ndikojë për të sjellë një rritje të besimit e për rrjedhojë edhe të bashkëpunimit me ne. Në këtë kuadër, jo vetëm se jemi në një proces vlerësimi (Vetingu), por synojmë që të punojmë fort me qëllim ruajtjen e etikës profesionale dhe morale, duke pasur si moto konsiderimin që prokurori dhe of.pol.gjyqësore jo vetëm gjatë orarit zyrtar të punës por edhe jashtë tij, në rrugë, në lagje, në lokale, duhet të përceptohet nga njerëzit të cilët kontaktojnë, si një njeri që ka marrë tashmë detyrime ndaj qytetarëve që me profesionin e tij të japë drejtësi penale të pavarur dhe të pandikuar nga faktorët korruptive, politik, etj.
- Administrimi më i mirë i sekretarisë, arkivit dhe i provave materiale mbetet sërish një angazhim i yni, pasi e konsiderojmë me rëndësi rregjistrimin e të dhënave të veprave penale, të autorëve të saj, sikundër edhe administrimin e dosjeve në përfundim të hetimit dhe gjykimeve, të provave materiale që ju bashkalidhen.
- Nga fundi, por jo më pak i rëndësishëm mbetet komunikimi me mediat lokale e qendrore duke ruajtur sekretin hetimor, të dhënave personale, kryesisht të të miturve e viktimave të veprës penale por, duke marrë përsipër informimin e publikut për punën, arritjet dhe sfidat që kemi në punën tonë të përditshme.

Ju faleminderit për vemëndjen!

DREJTUESI I PROKURORISË

ANTON MARTINI